



11

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE
SEKTORI JURIDIK

Nr 1687 prot

Datë, 01.11.2022

URDHËR

Nr, 8⁰ datë 01.11.2022

“FILLIMIN E PROCEDURËS TË PRANIMIT DHE SHQYRTIMIT TË DOKUMENTACIONIT NGA ANA E FAKULTETEVE TË UART, PËR STUDENTËT TË CILËT DO TË APLIKOJNË PËR PËRFITIMIN E BURSIVE NGA FONDI I MBËSHTETJES STUDENTORE, PËR STUDENTËT E SHKËLQYER, STUDENTËT QË STUDIOJNË NË PROGRAME STUDIMI NË FUSHAT PRIORITARE DHE STUDENTËT NË NEVOJË”, PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”

Në zbatim të nenit 112 të ligjit nr 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; të neneve 1 dhe 5 të ligjit 10289, datë 17.06.2010 për “Mënyrën e trajtimit ekonomik dhe financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të policisë së shtetit, të gardës së Republikës, të shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës të nenit nr 2 të ligjit nr 7889 datë 14.12.1994 për “Statusin e invalidëve të punës”(I ndryshuar); VKM nr. 869 datë 18.06.2008”Për zbatimin e ligjit nr.7889 datë 14.12.1994 për “Statusin e invalidëve të punës”(I ndryshuar);neni 6 të ligjit nr 8153, datë 31.10.1996 “Statusin e jetimit” (I ndryshuar); nenit 8 të ligjit nr.8098 datë 28.03.1996 për “Statusin e të verbërit” (I ndryshuar); neni 8 të ligjit 8626 datë 22.06.2000 për “Statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” (I ndryshuar);neni12 I ligjit nr.7748, datë 29.07.1993 për “Statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist” (I ndryshuar);nenit 32 të ligjit nr .9355, datë 10.03.2005 për “Ndihmën dhe shërbimet shoqërore” (I ndryshuar);të VKM nr.903, datë 21.12.2016 për “Përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi I mbështetjës studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë” (I ndryshuar);të VKM nr.39 datë 23.01.2019“ Për disa ndryshime në VKM nr 903, datë 21.12.2016” ,

URDHËROJ

- 1.Ngritjen e grupit të punës në Fakultetet e Universitetit të Arteve për pranimin dhe shqyrtimin e aplikimeve të studentëve që do të përfitojnë bursë për vitin akademik 2022-2023
- 2.Personat përgjegjës që do të merren me administrimin e procesit në çdo Fakultet, janë si më poshtë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nermin Zebi
Arta Dashi
Enela Mastori

Fakulteti i muzikës
Fakulteti I Arteve të Bukura
Fakulteti I Artit Skenik

3..Grupi i punës ka për detyrë të pranojë dhe të shqyrtojë dokumentacionin sipas kriterëve të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave, VKM nr.903, datë 21.12.2016 për “Përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjës studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë” (i ndryshuar)

4.Afati përfundimtar për dorëzimin e dokumentacionit nga studentët është data 25.11.2022

5.Grupi i punës, mban procesverbalin ku përcaktohen studentët që përfitojnë ose jo bursë për vitin akademik 2022-2023 dhe e përcjell dokumentacionin për verifikim Sektorit juridik.

6.Afati përfundimtar për dorëzimin e dokumentacionit, në zyrën e protokollit në Rektorat nga grupi i punës është data 01 dhjetor 2022

7.Pas verifikimit të dokumentacionit të grupit të punës, Sektori Juridik përgatitit informacionin për Administratorin e Universitetit të Arteve

8.Afati i fundëm për mbarimin e punës dhe dorëzimin e materialit përfundimtar administratorit nga Sektori Juridik është data 05 dhjetor 2022

9.Në çdo rast, kur një aplikant paraqet dokumentacionin për bursë për vitin akademik 2022-2023 që në të ardhmen rezultojnë jo ligjorë, përgjegjësia bije mbi studentin i cili penalizohet

10.Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhëri, Dekanët , sekretaritë në fakultete, zyra e protokollit në UART dhe sektori IT

11.Ky urdhër të shpallet në faqen zyrtare të web-it të Universitetit të Arteve dhe t’ju bëhet me dije studentëve dhe nëpërmjet afishimit në ambjente të dukshme të Fakulteteve të UART

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

Prof.Kastriot ÇAUSHI



REKTOR